



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPSHTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 pika, nenit 16 ,17 c), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008, Ligjit Nr. 07/I-001 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020 neneve 4.2, 14 ,nenit 7.2 dhe Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësive si dhe nenit 20 paragrafi.1 i Statutit të Komunës së Lipjanit, 1Nr.110-623 të datës 26.09.2008 Kuvendi i Komunës në mbledhjen urgjente të mbajtur në formë elektronike nga data 21.03.2020 deri me datë 23.03.2020, pas shqyrtimit të propozim vendimit të Kryetarit të Komunës miratoi këtë:

VENDIM

PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE PËR NDIHMA TË FAMILJEVE NË NEVOJE DHE NEVOJAT TË TJERA TË MENAXHIMIT TE SITUATËS EMERGJENTE NGA PANDEMIA COVID -

19

Neni 1.

NDAHET, shuma e mjeteve financiare ne vlerë prej 50,000.00€ (pesëdhjetë mijë euro) për ti mbështetur financiarisht familjet në nevojë në Komunën e Lipjanit si dhe për nevoja tjera me qëllim të menaxhimit të situatës emergjente nga pandemia COVID-19 që ka prekur edhe Komunën e Lipjanit.

Neni 2.

Mjetet e cekura në nenin 1 të këtij Vendimi, do të ndahen nga buxheti i Komunës së Lipjanit për vitin 2020, kategoritë ekonomike si vijon:

Shërbimet Kulturore (850) kodi i programit (85003):

Subvencione e Treansfere 15,000.00,

Bujqësia (470) Programi -47003

Subvencione e Treansfere.....15,000.00,

Infrastruktura Publike (180) Programi -18163

Mallra e Sherbime10,000.00,

75512 SHËRBIMET REZIDENCIALE – LIPJAN

Mallra e Sherbime.....10,000.00.

Totali i mjeteve 50,000.00€

Neni 3.

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

Neni 4.

Ky Vendim për shkak të situatës emergjente të shëndetit publik dhe nevojës urgjente për të vepruar hyn në fuqi menjëherë ditën e miratimit

15Nr. 400-16512

Lipjan, më 23.03.2020

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN



Kryesuesi i Kuvendit

Daut Azemi

Daut Azemi